

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Mars 2025

Tiranë, më 25 Prill 2025: Gjatë muajit Mars 2025, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 1.154.288 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 0,3 %, krahasuar me Mars 2024.


Nga territori i Republikës së Shqipërisë rezultojnë të kenë dalë 1.182.728 shtetas shqiptarë dhe të huaj, duke shënuar një rritje me 0,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Mars 2025, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 604.523, duke pësuar një rritje me 3,3 %, krahasuar me Mars 2024.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 549.765. Ky numër është ulur me 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (fig.1).

Fig.1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Mars 2024 - Mars 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Për publikim 25/04/2025

Daljet e shtetasve

Në muajin Mars 2025, 621.777 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 2,9 %, krahasuar me Mars 2024.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2025, janë 560.951. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është ulur me 1,9 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Mars 2024	Mars 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2025	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	1.150.442	1.154.288	0,3	3.161.751	3.371.766	6,6
Shqiptarë	585.467	604.523	3,3	1.626.638	1.745.547	7,3
Të Huaj	564.975	549.765	-2,7	1.535.113	1.626.219	5,9
Dalje Gjithsej	1.175.710	1.182.728	0,6	3.396.175	3.609.981	6,3
Shqiptarë	604.102	621.777	2,9	1.755.965	1.883.278	7,3
Të Huaj	571.608	560.951	-1,9	1.640.210	1.726.703	5,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Në Mars 2025, 95 % e hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nga rajoni i Evropës.

Evropa Jugore zë 80 % të hyrjeve të shtetasve të huaj nga kontinenti Evropian, ndjekur nga Evropa Perëndimore me 7 % (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Mars 2024	Mars 2025	Janar -Mars 2024	Janar -Mars 2025
Gjithsej	564.975	549.765	1.535.113	1.626.219
I . Afrika	1.648	2.297	3.082	5.439
II. Amerika	14.267	13.385	31.281	33.648
III. Azia Lindore dhe Paqësori	5.254	4.409	10.390	11.733
IV.Lindja e Mesme	721	862	2.057	2.892
V. Azia e Jugut	2.344	3.594	3.892	8.156
VI. Evropa	539.683	524.594	1.474.946	1.562.922
- Evropa Qëndrore / Lindore	33.137	25.832	69.471	66.501
- Evropa Veriore	25.274	22.489	56.591	57.202
- Evropa Jugore	426.950	420.903	1.234.236	1.306.255
- Evropa Perëndimore	39.215	37.326	76.301	84.970
- Evropa Lindore / Mesdheut	15.107	18.044	38.347	47.994
VII. Rajone të paspecifikuara	1.058	624	9.465	1.429

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 96 % të rasteve është për qëllime personale, ku dominojnë hyrjet për Pushime, vizitë tek të afërm, etj. Në Mars 2025, ky tregues ka shënuar një rënie me 1,1 %, krahasuar me Mars 2024. Hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime Biznesi dhe profesionale kanë rënë me 17,8 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Mars 2024	Mars 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2025	Ndryshimi në %
Hyrje shtetas të huaj	564.975	549.765	-2,7	1.535.113	1.626.219	5,9
I. Personale	540.205	529.397	-2,0	1.489.124	1.573.350	5,7
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	512.990	507.317	-1,1	1.423.466	1.513.028	6,3
2. Trajtime shëndetësorë	70	24	-65,7	179	90	-49,7
3. Qëllime fetare	55	37	-32,7	98	105	7,1
4. Udhëtarë transit	27.090	22.019	-18,7	65.381	60.127	-8,0
II. Biznes dhe profesionale	24.770	20.368	-17,8	45.989	52.869	15,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.